



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr.49, datë 18.10.2023


PËR

RISHIKIMIN E KUSHTEVE GJATË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN:
“OBJEKT SHËRBIMI DHE BANIMI 4 KATE ME 1 KAT PARKIM NËNTOKË DHE
PISHINË”, ME VENDNDODHJE POTAM, BASHKIA HIMARË, MIRATUAR ME
VENDIMIN E KËSHILLIT KOMBËTAR TË TERRITORIT NR.22, DATË 28.07.2020

Në mbështetje të neneve 27, 28 dhe 48 të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të shoqërisë “Bega 07” sh.p.k., Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e rishikimit të kushteve gjatë ndërtimit për objektin: “Objekt shërbimi dhe banimi 4 kate me 1 kat parkim nëntokë dhe pishinë”, me vendndodhje Potam, Bashkia Himarë, me zhvillues shoqërinë “Bega 07” sh.p.k., miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit Nr.22, datë 28.07.2020.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave, miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit Nr.21, datë 26.01.2020, zëvendësohet me Hartën e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumentin e Rregullores së Veçantë bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit për zbatimin e këtij vendimi në bashkëpunim me Bashkinë Himarë, për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHYLLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA

